



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 02**

**Datë: 19. 01. 2023. Ora: 13:30**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 1/2023

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**3. Raport nga Zyra ZRCKFSP**

Miratimi i vendimit për ndarjen e Fondit për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023.

**4. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim publik Për zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq

-Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe Agjendës: Punëtoria lidhur me veprimet, objektivat dhe aktivitetet strategjike për hartimin e Planit Strategjik 2023-2026

- **Këshilli par Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për punëtorinë: Hartimi i Planit Strategjik 2023-2026;

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të prokurimit për vitin 2023

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

-Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga OSBE/ODIHR për Reformën Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor në Varshavë.

-Njoftim nga A-ËEB-i lidhur me përdorimin e tarifave të anëtarësisë.

## **5. Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** Mirëse erdhët ! Po fillojmë mbledhjen e dytë, me rend dite që e keni përpara ( z. Radoniqi, e paraqiti agjendën e mbledhjes). KQZ, me 10 vota për, e miratoi rendin e ditës...

### **2.Aktivitetet e SKQZ-së:**

Burim Ahmetaj, tha se pjesë substanciale e punës sonë, është realizimi – hartimi i planit strategjik të KQZ-së për vitin 2023-2026. Deri me tani, sic e dini, është hartuar misioni, vizioni, parimet orientuese, analiza SËOT, shtyllat dhe synimet strategjike, mirëpo tash po përfshijmë ‘sipas kalendarit për hartimin e

strategjisë” objektivat dhe aktivitetet strategjike. Lidhur me këtë, është formuar nëngrupin punes për planin strategjik të KQZ-së 2023-2026 që përbëhet nga 5 zyrtarë nga Sekretariati dhe dy zyrtarë nga ZRCKFSP, që ka për qëllim koordinim e punëve dhe aktiviteve deri në finalizimin e dokumentit të Strategjisë së KQZ-së. Janë caktuar edhe personat përgjegjës ( janë në raport këta persona) për secilën shtyllë për hartimin e strategjisë, dhe anëtarët e grupit do të jenë përgjegjës për “shtyllat strategjike” me të cilat ngarkohen, dhe ata do të jenë përgjegjës për hartimin e strategjisë.

Kështu që në fund, tha z. Ahmetaj, anëtarët e këtij grupi do të jenë përgjegjës për veprimet strategjike, aktivitetet, objektivat, indikatorët, personat e tjerë përgjegjës me të cilët ata do të punojnë. Bartësit e shtyllave do të listojnë aktivitetet për shtyllën e tyre duke plotësuar me veprimet strategjike, objektivat, personat përgjegjës, aktivitetet strategjike, indikatorët dhe informata tjera dhe në fund para organizimit të punëtorisë, me datë 23 ose 24 janar 2023 të ketë një takim, ku do të diskutohen gjitha aktivitetet dhe veprimet sipas shtyllave dhe grumbullimin e tyre.

Po ashtu, tha z. Ahmetaj, sekretariati gjatë muajit janar 2023, do të Raportoje në KQZ Raportin T4 për vitin 2022 që përfshin Raportin përfundimtar për realizimin e planit të KQZ-së për vitin 2022, dhe Raporti Vjetor Financiar (RVF) 2022. Të dy këto raporte, do të prezantohen së bashku dhe jemi në pritje të kompletimit të RVF 2022, ku Zyrtari kryesor Financiar është duke punuar në sistemimin e dokumenteve në pajtim me rregulloren Nr. 01/2017 për Raportim financiar, mirëpo raporti nuk mund të dorëzohet pa barazim me Thesarin. Jemi në pritje të barazimit me Thesarin.

Këto raporte, do të shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor të KQZ-së 2022 për Kuvendin e Kosovës. Sekretariati ka filluar punën me hartimin e këtij raporti dhe sipas planit deri në fund të muajit mars 2023, parashiet të draftohet dhe gjatë muajit prill të shqyrtohet në KQZ.

Në vazhdim të aktiviteve të rregullta, Ahmetaj e informoi KQZ –në për donacionin e paisjeve. Para se të dhurohen këto pajisje si donacion, është dëshirë që ato të kontrollohen teknikisht dhe të përgatitet “lista” me numër serik për secilën pajisje që dhurohet. Deri me tani, janë kontrolluar 845 tabletë dhe kanë mbetur pa u kontrolluar edhe 9 pako me nga 10 Tabletë, do të thotë gjithsej edhe 90 pajisje.

Aktivitetet e tjera, në kuadër të planit të punës së vitit 2023 në zhvillim e sipër, janë: Planin i rekrutimit për vitin 2023; Organizimin e punëtorisë për hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së 2023-2026 i cili parashihet të kompletohet në javën e fundit të muajit shkurt 2023 dhe përgatitjen e materialeve për punëtorinë. Në lidhje me punëtorinë, ftesa për pjesëmarrje i është bërë edhe partnerëve të KQZ-së siq janë OSBE dhe Zyra e BE-së në Prishtinë; Vlerësimin e Pasurisë Jo financiare të KQZ-së;

Po ashtu, tha z. Ahmetaj ndër aktivitete të tjera janë edhe: Raportin përfundimtar i zbatimit të Planit të Punës së KQZ-së për Vitin 2022 së bashku me pasqyrat vjetore financiare PVF; Organizimimi për shënimin e Ditës Globale të Zgjedhjeve që do të mbahet me 2 Mars 2023, definimin e lokacionit në të cilën do të organizohet ngjarja, shpërndarja e ftesave dhe aktivitete tjera; Planin Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Zveçan dhe Leposaviq që do të mbahen me 23 Prill 2023; Rishikimi i specifikave të aktiviteteve të prokurimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme që do të mbahen më 23 Prill 2023. Është fjala për Informimin Publik dhe ID Bexhat për TMZ dhe Vëzhguesit; Plani i angazhimit të stafit jo permanent për këto zgjedhje, zhvillimi i procedurave për furnizime dhe shërbime për këto zgjedhje.

Në këtë pikë, diskutuan: Ibrahim Selmanaj, pyeti rreth planit për zgjedhjet në veri, meqë atje kryesuesit e KKZ-ve janë të dorëhequr...! A keni paraparë zgjidhje, pra cili është plani...? Gjithashtu, diskutoi edhe Arianit Elshani, Burim Ahmetaj.

## **6. Raport nga Zyra ZRCKFSP**

Miratimi i vendimit për ndarjen e Fondit për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023:

**Besnik Buzhala**, tha se zyra ua ka dërguar një rekomandim lidhur me fondin. Ai pastaj, shpjegoi procesin e ndarjes së fondit, duke marrë parasysh edhe gjendjen aktuale dhe, si është bërë ndarja. Zyra, tha z. Buzhala sipas subjekteve të përfaqësuara në kuvend - në bazë të ulëseve të përfaqësuara në kuvend, por edhe sipas parimeve ndërkombëtare në lidhje me ndarjen e fondit mbështetës të partive politike, sipas kodit të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore nga Komisioni i Venedikut, pastaj të OSBE/ODIRI-it, por edhe në bazë të rekomandimit nr. 1516 i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, kemi bërë analizën dhe këtë rekomandim...

Në dokument, subjektet janë të radhitura, ashtu si edhe draftvendimi, tha z. Buzhala.

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Ilir Gashi dhe Sami Hamiti.

Në fund, me 9 vota për dhe 1 abstenim u miratua fondi për mbështetjen e subjekteve politike për (Ilir Gashi) vitin 2023.

## **7. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim Publik Për zgjedhjet i jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:

**Arianit Elshani:** E kemi shqyrtuar këtë plan. Në kuadër të këtij plani, ashtu si edhe në të kaluar kemi bërë një plan që përcakton fushatat zgjedhore, mënyrat e votimit, dhe aktivitetet e tjera. Gjithçka, është në plan dhe, po ashtu edhe kostoja e kampanjës informative. Plani përfshinë tri gjuhët (shqip, serbisht dhe turqisht). D të përfshihen radiot, rrjetet sociale, video spotet, facebook...

**Kreshnik Radoniq:** A ka diçka për tu shtuar...?

Me 10 vota për miratohet ky plan.

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe Agjendës: Punëtorja lidhur me veprimet, objektivat dhe aktivitetet strategjike për hartimin e Planit Strategjik 2023-2026:

**Arianit Elshani:** E kemi shqyrtuar edhe këtë projekt lidhur me strategjinë, pra në kuadër të strategjisë mbajtjen e punëtorisë. Pra, strategjia ka edhe kosto buxhetore ! Ne në këshillë, duke e marrë parasysh rëndësinë e strategjisë, rekomandojmë gjithsesi që punëtorja të mbahet...

Me 10 vota për miratohet projekteti dhe mbajtja e punëtorisë.

### **2.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për punëtorinë: Hartimi i Planit Strategjik 2023-2026:

**Gordana Llaban:** Në këshill, ne kemi shqyrtuar planin e buxhetit për punëtorinë lidhur me hartimin e planit strategjik 2023-2026. Punëtorja, planifikohet të mbahet jashtë Kosovës dhe se, do të marrin pjesë 32 zyrtarë. Shpenzimet, i heqë KQZ. Përafërsisht, parashihet një kosto prej 19 488 euro. Ende, sështë planifikuar as vendi dhe as koha. Ne rekomandojmë që kjo punëtori të mbahet.

Me me 10 vota për, në parim, u miratua plani i buxhetit për mbajtjen e punëtorisë.

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të prokurimit për vitin 2023:

**Gordana Llaban:** Gjithashtu, e kemi shqyrtuar edhe planin e prokurimit për vitin 2023, dhe ne jemi dakorduar për këtë plan, dhe rekomandojmë KQZ për ta miratuar.

**Sami Kurteshi,** tha se problem kemi me veturat. Ma shtrenjtë po na kushtojnë kështu, se sa me i marrë me qira. Sido qoftë, është problem, nuk janë në gjendje të mirë dhe kjo, edhe duhet të shihet...Pastaj, edhe problemi i benxhave, kemi mendim edhe të auditorit dhe se 750 euro, janë vetëm për komunat e veriut. Unë, po pyes se ne a mund ti bëjmë vetë...E vërejtja edhe furnizimin me abteri dhe me uv – llampa. Me i heqë këto, dhe me gjetë forma tjera...! Ndoshta, duhet me mendue se a po e fusim në prokurim këtë, apo jo...?

Çështje tjetër, “kutitë e votimit”...! Janë rreth 50 000 euro. Janë dikur rreth 5000 kuti ! Kjo po më intereson...Ka edhe gjëra tjera...! Këto, ishin ato që më ranë në sy në plan...

**Sami Hamiti:** Ky plan, rrjedh nga buxheti i aprovuar. Ne, e kemi aprovuar... Ne, po bëjmë për herë të parë kërkesë për marrje me qira të vetuarave...Edhe kutitë, shuma që e shohim, nuk a shumë që shpenzohem...është projeksion...Për uv llampat, kanë filluar procedurat...S’kemi ba alternativë tjetër, kontratat janë shpall

Në përgjithësi, ky plan është kompatibil, por edhe unë besoj që mund të gjenden mundësi që ky buxhet me u shpenzue me nikoqirëllëk...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Burim Ahmetaj.

### **3.Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë:

**Sami Hamiti,** tha se në mbledhjen e mbajtur, kemi pasur kërkesën e kuvendit komunal të Pejës për një zëvendësim. Nga inisiativë “Boshnjakog Jedintva” ka dhënë dorëheqje Avdullah Djesheviq, dhe të njëjtin, e zëvendëson Skender Kandiç. Kushtet janë plotësue, dhe ne rekomandojmë këtë zëvendësim.

Me me 9 vota për, u miratua ky zëvendësim.

### **4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga OSBE/ODIHR për Reformën Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor në Varshavë:

**Kreshnik Radoniqi**: E kemi një ftesë nga OSBE/ODIHR për të marrë pjesë në një punëtori për Reformën Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor e cila mbahet në Varshavë. Në këshill, u dakordua të marrin pjesë dy persona. Është në gjuhën angleze punëtorja. Për emra nuk kemi biseduar.

**Ibrahim Selmajan**, propozoi që dikush nga Sekretariati të shkoj sepse, zgjedhjet janë temë e takimit...Le të shkojnë kryetari dhe Arianiti...Po votojmë dhe, nuk po e diskutojmë më shumë...

#### **Njoftim nga A-WEB-i lidhur me përdorimin e tarifave të anëtarësisë:**

**Burim Ahmetaj**, tha se e kemi një shkresë nga Aweb lidhur me tarifat për të gjitha organizatat që janë pjesë, dhe se na kanë sqaruar se që nga viti 2015 është marrë vendim që tarifa është 10 000 dollarë dhe kohëzgjatja është 1 vit. Mirëpo, tash tarifa është për dy vite, sepse kjo është edhe mundësi që organizatat anëtare të përfitojnë...

Në këtë pikë, **Arianit Elshani** tha se ka pranuar një imell për Kore dhe për dy aktivitete që planifikohen të mbahen. Kjo është për vitin 2024, mirëpo afati i aplikimit është deri më 31 janar të këtij viti. Unë, do ti përcjellë te sekretariati...

**Z. Elshani**, bëri vërejtje se imellat që vijnë, kanë vonesë. Kjo, s’duhet të lejohet... Po ashtu, vërejtje bëri edhe **Sami Kurteshi** që e quajti këtë papërgjegjësi... Po ashtu, vërejtje bëri edhe Kreshnik Radoniqi, që kërkoi që të mos neglizhohen informacionet, të kemi përgjegjësi...

Po ashtu, diskutoi edhe **Sami Hamiti**, por ai tha se vetëm një person në “burime njerëzore”, është e pamundur që t’i kryej të gjitha obligimet, përgjegjësitë...sidomos kur ka zgjedhje, ngarkesat administrative, kërkesat, informacionet janë problem...

**Sami Kurteshi**, tha se duhet të shihen mundësitë për rritjen e kapaciteteve, rekrutim për shembull, do të ketë nevojë edhe në Auditim për këtë...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Gordana Llaban, Burim Ahmetaj.

#### **5. Të ndryshme !**

